

Emri i Lëndës : Analizë Teksti I							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ELL 211	B	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	5.00
Lektori		Enriketa Sogutlu, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti		Albana Cekrezi, PhD					
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Lënda Analizë Teksti kurajon një lexim të avancuar dhe shkrimin për një varietet zhanrash në tekst: tregues, raportim, poezi, materiale akademike, artikuj etj. Kjo lëndë kërkon që studentët të arrijnë një nivel të lartë kompetence dhe rrjedhshmëri në të folur dhe të shkruar në gjuhën angleze, në këtë mënyrë 4 aftësi praktike do të zhvillohen në tekstet qe janë studiuar.					
Objektivat		Ne përfundim te kesaj lende, studentet duhet te përvetësojne njohuri mbi çfare eshte analiza e tekstit dhe llojet e analizave. Synohet analiza e teksteve duke filluar nga studimi i fjaleve tek kuptimi dhe domethenia me gjere. Gjithashtu synohet analiza e kontekstit, simboleve, temave kryesore etj.					
Konceptet Kryesore		Analize teksti, analitika e teksitit, analiza letrare, tregime te shkurtra, simbole, tema, imazhe, parathenie, ironi, korbi, shtëpia Usher, fucia me Amontijado, Annabel lee, maci i zi etj.					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Përse analiza e tekstit? Gjuha është një burim i madh të dhënash mbi fenomene komplekse. Tekstet mund të jenë gjurmë të një njësie më të madhe ose më interesante për studim. Kemi disa lloje analize teksti të strukturuar. Analiza e përmbajtjes analizon tekste të vogla dhe të izoluara si dhe prodhon kategori, frekuenca etj. Analiza semantike studion lidhjet midis njësive, lidhje gramatika dhe prodhon harta kuptimore etj. Analiza narrative i referohet strukturave më të mëdha të tekstit si elementët, ngjarjet etj. Analiza e diskursit përfshin disa lloje tekstesh dhe prodhon ideologji, mite institucionale apo kontradikta politike.						
2	Edgar Allan POE. Një prezantim i shkurtër i jetës, karrierës dhe punës së tij. Ai ishte një shkrimtar Amerikan, editor dhe kritik letrar. Poe është i mirënjohur për poezitë dhe tregimet e shkurtra. Tregimet e tij janë plot me mister dhe makabër. Poe ka qenë një figurë qendrore e Romanticismit në SH.B.A dhe letërsinë Amerikane. Ai cilësohet si shpikësi i zhanrit detektiv dhe më vonë si kontribues i zhanrit fantastiko shkencor.						
3	Rënia e shtëpisë Usher. Pjesa e parë e analizës prezanton lexuesin me personazhet kryesore, vendin dhe imazhin. Rrëfyesi i ngjarjes qëndron anonim përgjatë tregimit. Por, ne kuptojmë që ai është një mik fëmijërie, Roderick Usher dhe gjendet aty për një vizitë. Historia tregohet nga perspektiva e kufizuar e vetës së parë, që nënkupton tregimi do të jetë i limituar nga eksperiencia e tij. Gjithashtu, gjate kësaj pjese do të analizohen fjalë kyce që ndihmojnë në formimin e temave dhe imazhit.						
4	The Fall of the House of Usher 2-Personazhi kryesor i tregimit të shkurtër analizohen nëpërmjet fjalëve që thotë dhe veprimeve që bëjnë. Roderick Usher cilësohet si një karakter misterioz. Shtëpia e tij analizohet në detaje. Ajo cilësohet dhe si një karakter më vete me dualitin që shprehet në strukturën fizike dhe linjën familjare.						
5	The Fall of the House of Usher 3-Kjo pjesë është pjesa përfundimtare e analizës. Studentëve u kërkohet të analizojnë në mënyrë kritike përtej fjalëve dhe shprehjeve në tekst. Temat kryesore të tregimit si: vetmia, izolimi, frika analizohen në detaje. Gjithashtu pëfshihet dhe analiza e karaktereve.						

6	Annabel Lee është një poezi me rimë. Në të përshkruhet dashuria midis dy personazheve, Annabel Lee dhe narrator i cili mendohet të jetë vetë autori. Mendohet se poezia i referohet dashurisë që ai kishte për të afërmen e tij Virgia. Poezia përmban një atmosferë të mbinatyrshme me referime të ënjgjëjve dhe dajve të cilët mundohet të ndajnë dy të dashuruarit.
7	“Korbi”, I publikuar fillimisht në 1845, e bëri E.A. Poe të famshëm dhe mbetet vepra e tij më e arrirë. Atmosfera vetmitare, mesazhi tmerrues i korbit dhe bukuria gjithëpërfshirëse rezultojnë në një poemë të paharrueshme. “Korbi” është një tregim klasik mbi humbjen dhe vajtimin. Protagonisti i paidentifikuar, një shkollor, ulet në studion e tij në një mbrëmje nate dimri. Vajtimi i tij për të dashurën e vdekur shfaqet në formën e një korbi.
8	Provim Gjysmë-final
9	“Korbi” 2- Poe shpjegon në esenë e tij se burimi i shkrimit të Korbit nuk ka qenë një inspirim i rastësishëm. Përkundrazi, ai e përgatiti “Korbi”-n përmes një sërë vendimesh të përlogaritura. Pasi vendosi se gjatësia e përsorur e saj do ishin 100 rreshta dhe bukuria si efekti kryesor, Poe zgjodhi melankolinë si “manifestimin më të lartë të bukurisë” dhe “më të arsyeshmen e toneve poetike”. Sipas tij, historia e vdekjes të së bukurës Lenorë i erdhi në mendje pas refrenit të korbit “Kurrë më”.-një refren i zgjedhur për cilësitë e tij të tingullit. Historia e Lenorës shërben si zgjidhje pasi melankolia përkon me refrenin e korbit.
10	The Cask of Amontillado” (1846) (Fucia e Amontillados), ashtu si në shumë prej tregimeve të Poe-s, historia mbështet në mungesën e provave që shoqërojnë pretendimet e Montresor ndaj Fortunatos dhe “mijëra lëndime” dhe “ofendim”. Hakmarrja dhe “ofendimi”. Hakmarrja dhe vrasja sekrete janë si një mënyrë për të shmangur ligjin dhe dënimin. Ligji nuk gjendet gjëkund në radarin e Montresorit dhe tmerri në tregim qëndron në dënimin pa provë.
11	The Black Cat (Maci i zi)- Narratori tregon historinë e tij. Rrëfimi është në vetën e parë, qëndror dhe jo besueshëm. Poe krijon një dublim të tjetërsuar të tij.
12	The Black Cat (Maci i zi)-Figura letare: simbole, imazhe, tema, ironi. Demi shkaktuar syrit simbolizon ndryshimin e vizionit dhe na drejton në dhunë. Mizori ndaj kafshëve dhe abuzimi bashkëshortor ekspozohen më shumë. Sytë përfaqësojnë shpirtin. Sëpata simbolizon rrënimin e njeriut.
13	"The Tell-Tale Heart" është një tregim i shkurtër i Poe, rrëfyer nga një narrator i paidentifikuar i cili përpiket të bindë lexuesin se nuk është i marrë. Ndërkohë, rrëfen një vrasje që ka bërë. Viktima është një i moshuar me sy si shkaba. Vrasja është e mirëplanifikuar, dhe vrasësi fsheh trupin duke e copëtuar dhe fshehur në dërrasat e dyshemesë. Në përfundim, faji i rrëfyesit paraqitet në formën e një zëri, me shumë mundësi të një halucinacioni-atë të zemrës së të moshuarit që rreh nën dërrasat e dyshemesë.
14	Prezantime
15	Përsëritje
16	Provim Final
Parakushtet Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.	
Literatura • E. A. Poe , ``The Raven `` • E. A. Poe, ``The Black Cat`` • E. A. Poe, `` Annabel Lee`</li> <li>• E. A. Poe, `` The Fall of the House of Usher``	
Referenca të tjera • Katherine Mansfield-The Garden Party and Other Stories (Classic, 20th-Century, Penguin)-Penguin Classics (1998) • Allemano.J. Framework for proficiency, Hodder and Stoughton (FFP) • http://www.mendele.com/WWD/home.html • bbc.co.uk, thesaurus	
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentet do të përvetësojnë njohuri mbi çfarë është analiza e tekstit dhe llojet e analizave.
2	Studentët do të analizojnë kontekstin, simboleve, temave kryesore etj.
3	Studentët do të aftësohen në analizimin dhe shkrimin e eseve, duke reflektuar mendimin kritik gjatë analizës së teksteve.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	1	30	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			70
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			30
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	0	0
Detyra	1	0	0
Gjysmë finale	1	0	0
Provimi final	1	25	25
Të tjera	1	25	25
Ngarkesa totale e orëve			114
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.56
ECTS			5.00